



Prot. Nr. 31/2022

Tiranë, 15 qershor 2022

Disa lajme rreth vendimeve të marra në Asamblenë e Konferencës Ipeshkvore e mbajtur në datat 14-15 qeshor 2022.

- Konferenca Ipeshkvore ka zgjedhur **SH.T. Mons. Arjan Dodaj**, *Arqipeshkëv Metropolit i Tiranë-Durrësit*, President të Karitasit Kombëtar dhe **Znj. Juljana Reso**, Drejtoreshë e Karitasit Kombëtar.
- **Don Mark Shtjefni**, nga kleri i Dioqezës së Sapës, deri tani Zëdhënës i Shtypit KISH, është emëruar nga Kongregata për Klerin Rektor i Seminarit Ndërdioqezan “Zoja e Këshillit të Mirë” të Shkodrës.
- Po ashtu **Don Mark Pashkja**, nga kleri i Dioqezës së Shkodër-Pultit, është emëruar Zëdhënës i Shtypit i KISH.
- Me datë 29 tetor 2022 do të mbahet në Shkodër një ditë kushtuar përkujtimit të **400-vjetorit të themelimit të Propaganda Fide-s** dhe do të bashkëndahen rezultatet e konsultimit sinodal nëpër Dioqezat tona.
- Data 26 prill 2023 do të jetë një ditë përkujtimore kombëtare me rastin e **30 vjetorit të vizitës së papa Gjon Palit II në Shqipëri**.
- Gjatë plenares i është dërguar **një letër Atit të Shenjtë, papa Françeskut** duke i siguruar atij lutjen tonë për shëndetin e tij dhe për angazhimet e tij papnore.
- Në datat 22-26 qeshor 2022 do të kremtohet **Takimi Botëror i Familjeve** me temë: “*Dashuria familiare: thirrje dhe jetë shenjtërie*”. Të vlerësohet ky rast për nisma të ndryshme në famulli dhe dioqeza.
- Ipeshkëvinjtë do të kenë **ushtrimet shpirtërore** nga data 13-18 nëntor 2022 në shtëpinë e Etërve Karmelitanë në Nënshat.
- Me datë 21 qeshor 2022 do të kremtohet **Dita e Shenjtërimit Meshtarak** në ish-burgun e Spaçit në gjurmët e martirëve dhe të vuajtjes gjatë regjimit komunist. Janë të nxitur të gjithë meshtarët që të marrin pjesë.


Gjergj Meta

Ipeshkëv i Rrëshenit
Sekretar i Përgjithshëm KISH

